

Njoftim për përqendrim me të cilin 4iG Tavkozlesi Holding Zartkoruen Mukodo Reszvenitarsasag, Budapest, Hungari do të fitojë kontroll mbi Netfone Telekom Tavkozlesi es Szolgaltato Felelossegu Tarsasag, Zalaegerszeg, Hungari

(lënda nr. 08-121/2025)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për mbrojtje të konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 208/24 dhe 16/25), më datë 05.08.2025 në Komisionin për Mbrojtje të Konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim me të cilin 4iG Tavkozlesi Holding Zartkoruen Mukodo Reszvenitarsasag, shoqëri aksionare me seli të regjistruar në rr. Krisztina korut. nr. 39, 1013 Budapest, Hungari, do të fitojë kontroll mbi Netfone Telekom Tavkozlesi es Szolgaltato Felelossegu Tarsasag, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me seli në rr. Nefelejcs nr. 2/A, 8900 Zalaegerszeg, Hungari.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre afariste:

4iG Tavkozlesi Holding Zartkoruen Mukodo Reszvenitarsasag është shoqëri aksionare, e regjistruar për veprimtari kryesore si kompani holding, telekomunikacion dhe integrim të sistemeve IT, teknologji për hapësirë dhe mbrojtje, shërbime radiodifuzive dhe satelitore.

4iG Tavkozlesi Holding Zartkoruen Mukodo Reszvenitarsasag ka një subjekt të lidhur juridik në Maqedoninë e Veriut, dhe ai është Shoqëria për shërbime komunikimi ONE MAKEDONIA TELEKOMUNIKACIONE SHPKNJP Shkup, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar në pajtim me ligjet e Republikës së Maqedonisë së Veriut, me NUAS 7804148 dhe me seli në rr. "Crvena Voda" nr. 7/3, 1000 Shkup, Maqedonia e Veriut, me veprimtari parësore 61.20 – aktivitete të telekomunikimeve pa tela.

Netfone Telekom Tavkozlesi es Szolgaltato Felelossegu Tarsasag, është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, operator virtual mobil hungarez (MVNO) që ofron shërbime mobile, VoIP dhe internet duke përdorur infrastrukturën e operatorëve kryesorë të rrjetit, me fokus në paketa fleksibile tarfore dhe rrjet për shitje direkte. Veprimtaria e tij kryesore është telekomunikacioni me tel, pa tel dhe satelitor.

Netfone Telekom Tavkozlesi es Szolgaltato Felelossegu Tarsasag nuk ka subjekte të lidhura në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Për qëllime të vlerësimit të këtij përqendrimi, parashtruesi i njoftimit propozon që si treg relevant të merret tregu i përgjithshëm me pakicë për ofrimin e shërbimeve të telekomunikimeve mobile për të gjithë përdoruesit finalë në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bjerë nën dispozitat e Ligjit për mbrojtje të konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni i fton palët e treta të interesuara të dorëzojnë vërejtje dhe mendime për këtë përqendrim deri te Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të interesuara mund të dërgohen në adresën: rr. „Shën Kirili dhe Metodi“ nr. 54, Shkup ose në e-mail:

kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë te Komisioni brenda afatit prej 10 ditësh nga data e publikimit të këtij njoftimi.

07.08.2025

Shkup